

Kumtesë, 25 Janar pranë Sallës Lux-“Teca del Mediterraneo”

Alberto Fornasari-Ekspert në Proçeset Multi e Ndërkulturore.

“Edukimi ndërkulturor: problematikat e itineraret pedagogjike në shoqëritë komplekse”

Këtë kumtesë të shkurtër do ta nis me një analizë sociologjike përse sot është e nevojshme të flitet për edukim ndërkulturor.

Mendoj transformimet e thella të regjistruara në këto vite në lidhje me futjen në shtresën tonë sociale të personave me kombësi të ndryshme sjellës të kulturave të tjera, të traditave të tjera, të stileve të ndryshme jetese, sisteme të ndryshme vlerash, besime fetare të tjera.

Këto transformime të dukshme demografike të lidhura me flukset migratore kanë çuar shoqërine tonë në një rritje të konflikteve.

Prandaj në një shoqëri që zhvillohet drejt multietnikës është e nevojshme të flitet për edukim ndërkulturor; edukim ndërkulturor që konfigurohet si një edukim në marrëdhënie midis vetes dhe tjetrit, një edukim i drejtuar favorizimit të kontakteve dhe shkëmbimeve midis kulturave të ndryshme.

Për të evituar keqkuptimet, dua të nënvizoj mbi të gjitha, diferencat domethënëse midis multikulturës dhe ndërkulturës.

Për multikulturë i referohemi një situatë ku individë me eksperiencë e tradita kulturore të ndryshme bashkëjetojnë njëri pranë tjetrit pa patur marrëdhënie domethënëse.

Në këtë situatë marrëdhëniet i lihen rastit, ose varen nga interesat personale, ose janë të orientuara drejt një përshtatshmërie që synon reduktimin e dëmeve të një bashkëjetese të forcuar.

Multikultura e nënkuptuar esencialisht si politikë e ruajtjes së identiteteve etnike të ndryshme të pranishme në një territor, në një komunitet.

Kur flitet për ndërkulturën i referohemi një situatë multikulturore ku i kushtohet kujdes “ndër”, domethënë në marrëdhëniet midis subjekteve kulturore: një marrëdhënie që, duke evituar rreziqet e një asimilimi, lejon qarkullimin e elementëve kulturorë dhe një interpretim krijues të tyre në mënyrë që të arrihet në krijimin e një kodi komunikues të përbashkët midis kulturave.

Në këtë rast duhet të egzistojë një qëllimshmëri pedagogjiko-edukative për të vendosur kushtet optimale për marrëdhënien.

Pasi janë sqaruar diferencat domethënëse të këtyre dy termave nënvijëzohet sesi diskutimi ndërkulturor zhvillohet rreth dy nukleve: i pari që merr diversitetin jo si një pengesë e limit por si një mundësi dhe si një stimul për një pasurim personal e social; i dyti që njeh në komunikim strategjinë thelbësore për të zbatuar.

Komunikimi dhe konfrontimi që duhet të realizohet midis interlokutorëve që ndodhen në të njëjtin nivel; e kjo për të evituar rrezikun e një qëndrimi etnocentrik (ku vlerësohen elementët e një kulture tjetër sipas kriterëve të vlerësimit të kulturës tonë si “e vetmja universalisht e vlefshme”) që sigurisht çon në deformimin vlerësues të kulturës objekt i vëmendjes.

Prania e tjetrit, e të huajit humbet kështu dimensionin e tij të kërcënimit dhe merr një rol pozitiv, konstruktiv.

Edukimi ndërkulturor për të garantuar një qëndrim pluralist, fleksibël, të hapur ndaj diferencave dhe gati për ti integruar.

Por në këtë takim tonë me tjetrin mund të ndeshim barriera të padukshme: stereotipat dhe paragjykimet rreth bazës etnike.

paragjykimet dhe stereotipat të amplifikuar nga një sistem i mass-medias që për të bërë spektakël me lajmin krijon një imazh të imigratit të shoqëruar me episode kriminaliteti dhe emarxhinimi dhe nuk thekson proçeset e shumta të integritit që asistojmë çdo ditë.

Kjo ka pasoja shumë të rënda në dinamikat e integritit të të huajve të pranishëm në territorin italian; sociologjia e proceseve kulturore ka studiuar rëndësinë që mass-mediat kanë në kondicionimin e perceptimit tonë e kështu në orientimin drejt një qëndrimi mikpritjeje/hapje ose kundërshtimi/mbyllje.

Këtu lind nevoja e eliminimit me anë të kontaktit me tjetrin nëpërmjet një didaktike të pikëvështrimeve.

E shkollat e propozuara në trajnimin e qytetarëve të ardhshëm të botës, të një bote të globalizuar, janë institucionet e para që përfshihen në këtë proces shumë të rëndësishëm.

Prej pak kohësh është publikuar nga Instituti i Pedagogjisë Ndërkulturore të Universitetit të Barit – Fakulteti i Shkencave të Trajnimit, drejtuar nga prof. Luisa Santelli Beccegato një kërkim shkencor me titull “Të zotë për tu Zbuluar” nxënës të huaj e sukses arsimor; e në këtë kërkim kemi tentuar që me të dhëna të grumbulluara të rrëzojmë stereotipin e të huajit mbartës të problemeve në shkollë dhe kemi nënvijëzuar komponentin e suksesit arsimor.

Shkolla që, nëpërmjet praktikave pozitive, japin një sinjal pozitiv të përshtatshmërisë ndaj ndryshimeve sociale në zhvillim.

E kur flas për praktika pozitive i referohem binjakëzimeve, laboreve, laboreve gjuhësore, inserimit të mediatorëve gjuhësor-kulturorë, ekspertëve në proceset ndërkulturore.

Ndër praktikat pozitive mund të përmendim projektin “BiblicoDoc-Inn.” Akronim i Promovimit dhe zhvillimit të modeleve inovative të bashkëpunimit midis bibliotekave dhe qëndrave të dokumentimit italo-shqiptare që do t’ju prezantohet nga Rosalba Magistro.

Një linjë veprimi me vlerë të lartë ndërkulturore e këtij projekti është “Rafti multikulturor: shoku im i bankës Shqipëria”; projekt që nëpërmjet botimit dhe shpërndarjes në shkolla të buletinëve tematikë dygjuhësh (italo-shqiptare) të redaktuar nga të rinjtë italianë e shqiptarë ofron informacione të rëndësishme rreth kulturës, literaturës, gjuhës, traditave të kombit shqiptar (kjo për palën shqiptare ndërsa për palën italiane buletinët trajtojnë çështje në lidhje me marrëdhëniet transkufitare në Mesdhe dhe me informatizimin e Administratës Publike).

Këta buletinë do të studiohen më hollësisht nëpër shkolla falë ndërhyrjes së mediatorëve gjuhësor/kulturorë dhe ekspertëve të sektorit.

Theksoj si këta buletinë anullojnë rrezikun e një qëndrimi etnocentrik, respektojnë kulturën dhe traditat shqiptare, duke folur për kulturën shqiptare sipas asaj që një antropolog amerikan Clifford Geertz ka quajtur “Këndvështrimi i vendasve”.

Kultura e një Vendi duhet të tregohet dhe përshkruhet nga kush është pjesëtar i asaj kulture, në brendësi të sistemit, e jo nga kush është “i huaj” për sistemin që kërkon të dekodifikojë simbolet.

E kjo sepse Shqipëria të mos jetë e lidhur vetëm me atë foto historike që secili nga ne ruan në memorie të një anijeje shprese “plotë” me njerëz por duam që Shqipëria të na sjellë ndërmend kulturën e një populli, traditat e tij, literaturën e tij.

Alberto Fornasari